



Republika e Kosovës

Republika Kosova


Republic of Kosovo



Kuvendi i Komunës

Skupština Opština

Municipal Assambly



## KONTRATËN PUBLIKE KORNIZË – SHËRBIM

### PJESA I E KONTRATËS: KONTRATA PUBLIKE KORNIZË

**KUVENDI I KOMUNES - KAÇANIK**, (në vazhdim "Autoriteti Kontraktues"), në njëren anë; te cilen e perfaqson Shefket Koxha Menagjer i ZP dhe N.SH. "3D-PROJECT" *i përfshuar nga Ardit Abazaj me ID-1240284851* (ne vazhdim "Ofruesi i Shërbimeve"), ne anën tjetër, janë pajtuar te lidhin një kontrate publike për Shërbimet në vijim:

**Hartimi i Projekteve për komunën e Kaçanikut**

me numër identifikues: 652-23-10951-2-2-1 (KA652/023/094/221).

#### Neni 1 Lënda

1.1 Lënda e kësaj kontrate publike kornizë është qe të themeloj kushtet, duke përfshirë çmimet per njësi dhe rregullat e implementimit për kryerjen e shërbimeve në vijim:

1.2 Kontrata publike kornizë do të implementohet me "vendosjen e porosive" apo thirrje. P.sh. Kurdo që Autoriteti Kontraktues apo ndonjë Autoritet tjetër Kontraktues i përfshirë në këtë kontratë, tenton të blejë artikuj në bazë të kësaj kontrate publike kornizë, duhet që të dërgojë "porosinë" tek Ofruesi i shërbimeve, duke specifikuar listën e shërbimeve qe duhet te performohen me sasitë e tyre përkatëse.

1.3 Sositë e vlerësuara, të përcaktuara në Pjesën C, Lista e Çmimit, janë vetëm sasi indikative. Autoriteti(et) Kontraktues i përmendor në Nenin 1.1 është (janë) i/të detyruar të përdorin këtë marrëveshje kornizë sa herë që të prokurojnë shërbimet e përmendura në 1.1.

1.4 Kontrata hynë në fuqi me **22.12.2023** dhe përfundon në datën **21.11.2026**

#### Neni 2 Koha e përfundimit

2.1 Afati kohor për kryerje të shërbimeve do të jetë 15 ditë nga koha e lëshimit të urdhër blerjes nga ana e Autoritetit Kontraktues.

2.2 Vendi i kryerjes së shërbimeve do të jetë ne selin e OE.

#### Neni 3 Çmimi

B28 Dosja e Tenderit për Kontratën Publike Kornizë – Shërbim

1

1/12  
fuz

3.1 Çmimet njësi të shërbimeve janë paraqitur në Ofertën Financiare, Lista e Çmimit e paraqitur nga Ofresi i Shërbimeve. (çmimi per njisi 2.28€ ).

Vlera totale e kontratës është 120.000,00€ Euro.

3.2 Çmimi i përmendur në Nenin 3.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Ofresit te Shërbimeve sipas kontratës publike kornizë.

3.3 Çmimet e njësive do të janë fikse dhe nuk do ti nënshtrohen ndryshimeve për porositë e vendosura nën këtë kontratë publike kornizë.

3.4 Pagesat do të bëhen në përputhje me Kushtet e Përgjithshme dhe/ose të Veqanta të Kontratës.

#### Neni 4 Rendi i përparësisë së dokumenteve të kontratës

4.1 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:

- (a) Kontrata Publike Kornizë;
- (b) Kushtet e Veçanta të Kontratës;
- (c) Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
- (d) Tenderi i Ofresit te Shërbimeve, duke përfshirë Specifikimet Teknikë;
- (e) Oferta financiare (Lista e Çmimeve);
- (f) Urdhër blerja;
- (g) *[sheno çdo dispozitë tjeter të dosjes së tenderit].*

4.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në raste të paqartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër.

#### Neni 5 Komunikimet


5.1 Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues, nga njëra anë dhe Ofresit të Shërbimeve nga ana tjeter duhet të cekin titullin e Kontratës dhe numrin e saj të identifikimit dhe duhet të bëhen me shkrim. Komunikatat duhet të dërgohen me postë, mesazh, telefaks, faks, email ose të dorëzohen personalisht.

5.2 Nëse personi që dërgon komunikatën kërkon vërtetim të pranimit të saj, ai duhet ta thotë këtë në komunikatën e tij. Sa herë që ka afat të fundit për pranimin e komunikatës me shkrim, dërguesi duhet të kërkojë vërtetim të pranimit të komunikatës së tij. Në të gjitha rastet, dërguesi duhet t'i marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar pranimin e komunikimit të tij.

5.3 Kudo që në kontratë parashikohet dhënia e ndonjë njoftimi, pëlgimi, miratimi, certifikate, ose vendimi, përvçe nëse specifikohet ndryshe në njoftimin e tillë, pëlgim, miratim, certifikatë apo vendim do të jetë në formë të shkruar dhe fjalët "njoftoj", "vërtetojë", "miratoj" ose "vendosë" "do të shenohen në përputhje me rr Ethanat. Ndonjë miratim, pajtim, certifikatë ose vendimi i tillë nuk duhet të mbahet apo vonohet pa arsy.


5.4 Kjo kontratë është përgatitur në gjuhet **[Shqipe]** në tri originale, dy originale për Autoritetin Kontraktues dhe një original për Ofresin e Shërbimeve.

Për Autoritetin Kontraktues

Emri:	Shefket Koxha
Pozita:	Zyrtar përgjegjës i prokurimit *
Nënshkrimi:	
Data:	21. XII. 2023
Vula:	



Për Ofruesin e Shërbimeve

Emri:	Ardit Abazaj
Pozita:	I autorizuar
Nënshkrimi:	
Data:	21.12.2023
Vula:	



## **PJESA II E KONTRATËS KUSHTET E PËRGJITHSHME**

### **Neni 1 Përkufizimet**

- 1.1 "Kontratë" do të thotë marrëveshja e lidhur ndërmjet Autoritetit kontraktues dhe Ofritesit të Shërbimeve, siç është shënuar në formularin e kontratës të nënshkruar nga palët, duke përfshirë të gjitha shtojcat për këtë dhe të gjitha dokumentet e inkorporuar me referencë në të.
- 1.2 "Shërbimet" do të thotë shërbimet qe do te ekzekutohen nga ana e Ofritesit e Shërbimeve në pajtim me Specifikimet dhe Përshkrimin e Çmimit te përfshira në Tenderin e Ofritesit të Shërbimeve.
- 1.3 "Ofrites i shërbimeve" është Operatori Ekonomik ose grupi i Operatorëve Ekonomik, i caktuar në formularin e kontratës, që është palë në kontratë dhe i detyruar të kryej detyrat në bazë të marrëveshjes, dhe që për detyrat e kryera do të marrë shumën e rënë dakord në formularin e kontratës.
- 1.4 "Personeli" do të thotë personat e angazhuar nga Ofitesi i Shërbimeve ose nga Nën-kontraktuesi si të punësuar dhe të caktuar për kryerjen e shërbimeve ose të ndonjë pjesë të tyre.
- 1.5 "Çmimi i kontratës" do të thotë shuma e deklaruar në Marrëveshjen që përfaqëson shumën totale të pagueshme për ofrimin e Shërbimeve.
- 1.6 "Nënkontraktuesi" do të thotë çdo person fizik, privat ose subjekt i qeverisë, ose kombinimi i tyre, duke përfshirë edhe pasardhësit e tij ligjor ose transferimet e lejuara, për të cilin çdo pjesë e Shërbimeve do të sigurohet ose ekzekutimi i ndonjë pjesë të Shërbimeve është nënkontraktuar nga Ofitesi i Shërbimeve.
- 1.7 "Palë" nënkupton Autoritetin Kontraktues ose Ofitesin i Shërbimeve, siç mund të jetë rasti, dhe "Palë" nënkupton të dy prej tyre.
- 1.8 "Autoriteti Kontraktues" nënkupton autoritetin që blen Shërbimet, siç specifikohet në Kontratë.
- 1.9 "KPK" nënkupton Kushtet e Përgjithshme të Kontratës.
- 1.10 "KVK" nënkupton Kushtet e Veçanta të Kontratës.

### **Neni 2 Gjuha dhe ligji i aplikueshëm**

- 2.1 KVK e saktësojnë cili është ligji që i përcakton të gjitha çështjet që nuk janë të mbuluara në kontratë.
- 2.2 Kontrata dhe të gjitha komunikimet e shkruara ndërmjet palëve hartohen në gjuhën e specifikuar në KVK.

### **Neni 3 Transferimi**

- 3.1 Transferimi do të jetë valid vetëm nëse ka marrëveshje të shkruar përmes të cilës Ofitesi i Shërbimeve e transferon kontratën e vet ose një pjesë të saj te një palë e tretë.
- 3.2 Ofitesi i Shërbimeve nuk mundet që, pa miratim paraprak me shkrim nga Autoriteti kontraktues, ta transferojë kontratën ose një pjesë të saj, ose ndonjë përfitim apo interes nga ajo, përvçe në këto raste:
  - a) kur ka ngarkesë për pagesë, në favor të bankierëve të Ofitesit të Shërbimeve, të shumave që duhet të paguhen ose që do të bëhen borxh sipas kontratës; ose
  - b) në rast të dhënies së të drejtës së Ofitesit të Shërbimeve siguruesve të Ofitesit të Shërbimeve për të kërkuar pagesën nga ndonjë person tjetër i detyruar në rastet kur siguruesit e kanë shkarkuar humbjen ose detyrimin e Ofitesit të Shërbimeve.
- 3.3 Për qëllimet e nenit 3.2, aprovimi i një transferimi nga Autoriteti kontraktues nuk do ta lirojë Ofitesin e Shërbimeve nga obligimet e veta për pjesën e kontratës që tashmë është realizuar ose për pjesën që nuk është bartur.

3.4 Pranuesit e dispozitave të kontratës duhet të plotësojnë kriteret e përshtatshmërisë që zbatohen për dhënien e kontratës përvèç në raste kur transferimi bëhet në bankë apo kompani të sigurimit ose institucion tjetër financiar.

#### Neni 4 Nën-kontraktimi

4.1 Nënkontrata është valide vetëm nëse ka marrëveshje të shkruar përmes së cilës Ofruesi i Shërbimeve ia beson realizimin e një pjese të kontratës së tij një pale të tretë.

4.2 Elementet e kontratës që do të nënkontraktohen dhe identiteti i nënkontraktuesve i bëhen të ditura Autoritetit kontraktues me rastin e dorëzimit te ofertes. Ne rast te ndryshimit te nënkontraktuesve gjate implementimit te kontrates, Ofruesi i Shërbimeve duhet te njoftoj me shkrim Autoritetin Kontraktues. Autoriteti kontraktues do ta lajmërojë Ofruesin e Shërbimeve për vendimin e vet brenda 30 ditës pune nga marrja e njoftimit, duke i paraqitur arsyet e veta nëse nuk lëshohet autorizimi. Ofruesi i Shërbimeve nuk nënkontraktion pa autorizim me shkrim nga Autoriteti Kontraktues. Te gjithe nënkontraktuesit e propozuar duhet te përmbushin kërkesat e pershtatshmerise.

4.3 Autoriteti kontraktues nuk njeh lidhje kontraktore ndërmjet vetes dhe nënkontraktuesve, megjithatë mund të siguroj, ku e konsideronë si të nevojshme, pagesat direkte për nënkontraktorët.

4.4 Ofruesi i Shërbimeve është përgjegjës për aktet, gabimet dhe neglizhencën e nënkontraktuesve të vet si dhe të agjentëve ose të punësuarve, në të njëjtën mënyrë si po të ishin akte, gabime ose neglizhencë e Ofruesit të Shërbimeve, agjentëve të tij ose punëtorëve të tij. Aprovimi i nënkontraktimit të ndonjë pjese të kontratës ose aprovimi i nënkontraktuesit nga ana e Autoritetit kontraktues nuk e liron Ofruesin e Shërbimeve nga obligimet e tij sipas kontratës.

#### Neni 5 Tatimi

5.1 Ofruesi i Shërbimeve është përgjegjës për të gjitha tatimet dhe detyrimet doganore në përputhje me Ligjin e Republikës se Kosovës.

5.2 Të gjitha tatimet dhe detyrimet tjera doganore konsiderohet se janë përfshirë në çmimin e kontraktuar.

5.3 Menaxheri i Projektit do të harmonizojë çmimin e kontraktuar nëse konstaton se ka ngritje të tatimeve dhe detyrimeve doganore brenda datës prej 28 ditësh para dorëzimit të tenderit dhe datës së fundit të vërtetimit të ekzekutimit te shërbimeve.

5.4 Menaxheri i Projektit nuk do të lejojë ndryshimin e çmimit të kontraktuar për shkak të ngritjes së tatimeve dhe/ose ngritjes se detyrimeve doganore në qoftë se kjo ka ndodhur gjatë kohës sa ka qenë në vonesë Ofruesi i Shërbimeve.

#### Neni 6 Fillimi dhe Ekzekutimi i shërbimeve

6.1 Ofruesi i shërbimit duhet të fillojë shërbimet sa më shpejt që është e arsyeshme e mundur pas marrjes së urdhrit me ekspeditën e duhur dhe pa vonesë.

6.2 Ofruesi i Shërbimeve do të përfundoj aktivitetet veprimtari brenda afatit kohor të specifikuar në Nenin 2 të Formularit të Kontratës. Nëse Ofruesi i Shërbimeve nuk i përfundon aktivitetet në datën e caktuar, ai do të jetë përgjegjës për të paguar dëmet e likuiduara. Në këtë rast, Data e Përfundimit do të jetë data e përfundimit te të gjitha aktiviteteve.

#### Neni 7 Zgjatja e periudhës së ekzekutimit

7.1 Ofruesi i shërbimit mund të kërkojë zgjatje të periudhës së ekzekutimit nëse realizimi i kontratës së tij vonohet, ose pritet se do të vonohet, për ndonjëron nga këto arsyë:

- a) dështimi i Autoritetit Kontraktues për të përmbushur detyrimet e tij sipas kontratës;
- b) forcë madhore siç përcaktohet në nenin 8;

7.2 Brenda 15 ditëve me të kuptuar se një vonesë mund të ndodhë, Ofruesi i Shërbimeve do të njoftoj Autoritetin Kontraktues mbi qëllimin e tij që të bëj një kërkesë për zgjatjen e periudhës së realizimit për të cilën ai konsideron se ka të drejtë dhe, përvèçse kur është rënë dakord ndryshtësia ndërmjet ofruesit të shërbimeve dhe Autoritetit Kontraktues, brenda 30 ditëve nga e njëjta pikë në kohë të sigurojë Autoritetin Kontraktues me hollësi të plotë në mënyrë që të mund të shqyrtohet kërkesa.

7.3 Brenda 30 ditëve nga marrja e hollësive të përmendura në 7.2, Autoriteti Kontraktues me anë të njoftimit me shkrim do t'i lejoj Ofruesit të Shërbimeve zgjatjen e periudhës së ekzekutimit siç mund të arsyetohet, ose në mënyrë prospektive dhe retrospektive, ose të informoj Ofruesin e Shërbimeve që ai nuk ka të drejtë në zgjatje.

## Neni 8 Forca Madhore

8.1. Asnjëra palë nuk konsiderohet se ka bërë shkelje të obligimeve të saj sipas kontratës nëse realizimi i obligimeve të tillë parandalohet nga ndonjë ngjarje e shkaktuar nga një forcë *madhore* që shkaktohet pas datës së njoftimit mbi dhënien të kontratës ose kur kontrata hyn në fuqi.

8.2. Termi "forcë madhore" do të thotë veprimet e zotit, goditjet, mbylljet e objektit ose çrregullimet tjera industriale, veprimet e armikut publik, luftërat qofshin të deklaruara ose jo, blokadat, rebelimet, rastet e dhunës, epidemitë, rrëshqitjet e tokës, tërmimet, shtrëngatat, vërtëtima, vërsimet, erozionet, trazirat civile, eksplodimet dhe ndonjë ngjarje tjetër e ngashme e paparashikuar që është përtej kontrollit të palëve dhe nuk mund të përballohet as me kujdesin e duhur.

8.3. Pala e ndikuar nga një ngjarje e forcës madhore do të marr të gjitha masat e arsyeshme për të mënjanuar paaftësinë e një pale të tillë që të përbush detyrimet e saj tani e tutje me një vonesë minimale.

8.4. Ofroresi i Shërbimeve nuk do të jetë përgjegjës për dëmet e likuiduara ose ndërprerje nëse vonesa e tij në realizimin ose dështimi për të realizuar obligimet e tij me kontratë është rezultat i një ngjarjeje të forcës madhore. Autoriteti kontraktues nuk do të jetë i detyruar të paguajë interes për pagesat e vonuara, për mosrealizim ose për ndërprerje nëse vonesa e Autoritetit kontraktues ose lloj tjetër i dështimit për të kryer obligimet e tij është rezultat i forcës madhore.

8.5. Nëse ndonjëra palë konsideron se ndonjë rrethanë e forcës madhore ka ndodhur e cila mund të ndikojë në realizimin e obligimeve të saj, menjëherë do ta lajmërojë palën tjetër, duke dhënë të dhëna detaje mbi natyrën, kohëzgjatjen e mundshme dhe efektin që kanë gjasa ta kenë rrethanat. Përveç nëse udhëzohet ndryshe nga Menaxheri i Projektit me shkrim, Ofroresi i Shërbimeve do të vazhdojë t'i realizojë obligimet e tij sipas kontratës përderisa është mjaft praktike, dhe të angazhojë të gjitha mjetet e arsyeshme alternative për të plotësuar ndonjë obligim që ngjarja e forcës madhore të mos e pengojë atë gjatë punës. Ofroresi i Shërbimeve nuk do të zbatojë mjete të tillë alternative përvëç nëse udhëzohet ta bëjë këtë nga Menaxheri i Projektit.

## Neni 9 Ndërprerja e Kontratës nga Autoriteti Kontraktues

9.1 Autoriteti kontraktues mundet që, pasi t'i japë Ofroresit të Shërbimeve 14 ditë paralajmërim, ta ndërpresë kontratën në ndonjërin nga rastet e mëposhtme:

- (a) Ofroresi i Shërbimeve dështon në përbushjen brenda një afati të arsyeshëm të paralajmërit të dhënë nga autoriteti kontraktues që kërkon nga ai të evitojë ndonjë neglizhencë apo dështim për të realizuar obligimet e veta sipas kontratës, dhe të cilat ndikojnë në mënyrë serioze në realizimin e duhur dhe me kohë të shërbimeve;
- (b) Ofroresi i Shërbimeve refuzon ose është neglizhent në realizimin e urdhreve administrative të dhëna nga autoriteti kontraktues;
- (c) Ofroresi i Shërbimeve ia jep dikujt kontratën apo nënkontratën pa autorizim nga Autoriteti kontraktues;
- (d) Ofroresi i Shërbimeve falimenton ose është duke u mbyllur; punët e tij janë duke u administruar nga gjykatat, ka hyrë në marrëveshje me kredituesit, ka pezulluar aktivitetet biznesore, i nënshtronhet procedurave ligjore lidhur me ato çështje, ose është në ndonjë situatë analoge që shkaktohet nga ndonjë procedurë e ngashme e paraparë në legjislacionin apo në rregulloret nacionale;
- (e) Ofroresi i Shërbimeve është dënuar për një shkelje që ka të bëjë me sjelljen profesionale, përmes një gjykimi që ka fuqinë e *res judicata*;
- (f) Ofroresi i Shërbimeve është shpallur fajtor për sjellje të rëndë të keqe jo profesionale të dëshmuar me çfarëdo mjeti të cilin mund ta vërtetoj Autoriteti kontraktues;
- (g) Ofroresi i Shërbimeve i është nënshtruar një gjykimi që ka forcën e *res judicata* për mashtrim, korruption, përfshirje në ndonjë organizatë kriminale;
- (h) të gjitha modifikimet organizative që përfshijnë ndryshime në personalitetin ligjor, natyrën ose kontrollin e Ofroresit të Shërbimeve, përvëç nëse këto modifikime regjistrohen në suplementin e kontratës;

- (i) shfaqet ndonjë paaftësi tjetër ligjore që i pengon realizimit të kontratës;
- (j) Ofrofuesi i Shërbimeve nuk arrin të japë garancinë ose sigurimin e kërkuar, ose nëse personi që e jep garancinë apo sigurimin më të hershëm të kërkuar në kontratën e tanishme nuk është në gjendje t'i plotësojë zotimet e tij.

9.2 Ndërprerja do të bëhet pa paragjykim ndaj të drejtave apo mundësive tjera të Autoritetit kontraktues dhe Ofrofuesit të Shërbimeve sipas kontratës. Autoriteti kontraktues, pas kësaj mund të nënshkruajë ndonjë kontratë tjetër me një palë të tretë në emër të Ofrofuesit të Shërbimeve.

9.3 Autoriteti Kontraktues, pas lëshimit të njoftimit të ndërprerjes së kontratës, do ta udhëzojë Ofrofuesin e Shërbimeve që të ndërmarrë hapa të menjëhershëm për ta përmbyllur ekzekutimin e shërbimeve në mënyrë të shpejtë dhe të rregullt dhe për t'i zgjedhur në minimum shpenzimet.

9.4 Në rast të ndërprerjes, autoriteti kontraktues, sa më shpejt që të jetë e mundur dhe në prani të Ofrofuesit të Shërbimeve ose të përfaqësuesve të tij ose duke u bërë atyre thirrjen e duhur, do ta përgatisë një raport mbi shërbimet e kryera. Do të përgatitet edhe një deklaratë e parave që duhet t'i paguhen Ofrofuesit të Shërbimeve dhe parave që i ka borxh Ofrofuesi i Shërbimeve Autoritetit kontraktues në datën e ndërprerjes së kontratës.

9.5 Autoriteti kontraktues nuk do të jetë i obliguar të bëjë pagesa tjera për Ofrofuesin e Shërbimeve derisa të jenë përfunduar shërbimet, ndërsa Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë të marrë nga Ofrofuesi i Shërbimeve koston ekstra, nëse ka, për të siguruar ofrofuesin e shërbimeve ose do të paguajë shumën që duhet t'i paguhet Ofrofuesit të Shërbimeve para ndërprerjes së kontratës.

9.6 Nëse Autoriteti kontraktues e ndërpres kontratën, ai do të ketë të drejtë të marrë nga Ofrofuesi i Shërbimeve humbjet që i janë shkaktuar nën kushtet e kontratës.

#### **Neni 10 Ndërprerja e Kontratës nga Ofrofuesi i Shërbimeve**

10.1 Ofrofuesi i Shërbimeve, pasi e ka paralajmëruar Autoritetin kontraktues 14 ditë paraprakisht, mund ta ndërpresë kontratën nëse Autoriteti kontraktues;

- a. nuk arrin t'i paguajë Ofrofuesit të Shërbimeve shumat që duhet të paguhen në ndonjë certifikatë të lëshuar nga personi i autorizuar pas skadimit të afatit të fundit;
- b. vazhdimesht nuk arrin t'i plotësojë obligimet e veta edhe pas rikujtimeve të përsëritura; ose
- c. ose, si rezultat i Forcës Madhore, Ofrofuesi i Shërbimeve është i paaftë të kryej një pjesë materiale të Shërbimeve për një periudhë prej jo më pak se gjashtëdhjetë (60) ditë.

10.2 Ndërprerja do të bëhet pa paragjykim për ndonjë të drejtë apo autoritet tjetër sipas kontratës së Autoritetit kontraktues dhe Ofrofuesit të Shërbimeve.

10.3 Në rast të ndërprerjes sipas paragrafit (a) dhe (b) te Seksionit 10.1, Autoriteti kontraktues do ta paguajë Ofrofuesin e Shërbimeve për humbje ose dëm që mund t'i jetë shkaktuar Ofrofuesit të Shërbimeve.

#### **Neni 11 Obligimet e Ofrofuesit të Shërbimeve**

11.1 Ofertuesi do të kryejë Shërbimet sipas kontratës me kujdes, efikasitet dhe zell, në përputhje me praktikat më të mira profesionale.

11.2 Ofrofuesi i Shërbimeve duhet të pajtohet me urdhërat administrative të dhëna nga Autoriteti Kontraktues. Kur Ofrofues i shërbimeve konsideron se kërkesa e një urdhri administrativ shkon përtëj fushëveprimit të kontratës, ai, duke iu ekspozuar dënimit për shkelje të kontratës, do ta njoftojë autoritetin kontraktues për këtë duke i paraqitur arsyet e tij brenda 30 ditësh pas pranimit të urdhrit. Ekzekutimi i urdhrit administrativ nuk do të pezullohet për shkak të këtij njoftimi.

11.3 Ofrofuesi i Shërbimeve duhet t'i respektojë dhe të veprojë sipas të gjitha ligjeve dhe rregulloreve në fuqi në Republikën e Kosovës dhe do të sigurojë që personeli i tij, të afërmët e tyre, dhe punëtorët vendorë të tij gjithashtu t'i

respektojnë dhe të veprojnë sipas këtyre ligjeve dhe rregulloreve.

11.4 Ofruesi i Shërbimeve do të trajtojë të gjitha dokumentet dhe informacionet e marra në lidhje me kontratën si private dhe konfidenciale. Ai nuk do të shpëtojë për aq kohë sa të jetë e nevojshme pér qëllimet e ekzekutimit të kontratës, të batojë ose të zbulojë ndonjë të dhënë të kontratës, pa pëlqimin paraprak me shkrim të Autoritetit Kontraktues.

11.5 Nëse ofruesi i shërbimit është një konsorcium i dy ose më shumë personave ose korporatave, të gjithë personat ose korporatat e tilla do të jenë së bashku dhe veçmas të detyruar pér të përm bushur kushtet e kontratës. Personi i caktuar nga konsorciumi pér të vepruar në emër të tij pér qëllimet e kësaj kontrate do të ketë autoritetin pér të lidhur konsorciumin. Përbërja e grupit nuk do të ndryshohet pa pëlqimin paraprak me shkrim të Autoritetit Kontraktues.

11.6 Ofruesi i Shërbimeve do të punësojnë personelin kyç të identifikuara në tenderin e tij pér të kryer funksionet e përcaktuara në tenderin e tij. Për më tepër, gjatë performancës, dhe në bazë të një kërkese me shkrim dhe të arsyetuar, autoriteti kontraktues mund të kërkojë një zëvendësim nëse vlerëson se një anëtar i stafit është i paefektshëm ose nuk kryejnë detyrat e tij sipas kontratës. Autoriteti Kontraktues do të miratojë çdo zëvendësim të personelit kryesor të propozuar vetëm nëse kualifikimet e tyre përkatëse dhe aftësitetë në thelb janë të barabarta ose më të mirë se ato të identifikuara.

#### Neni 12      Obigimet e Autoritetit Kontraktues

12.1 Autoriteti Kontraktues do të ofrojë ofruesit të shërbimit menjëherë me ndonjë informacion dhe / ose dokumente në dispozicion të saj, të cilat mund të jenë relevante pér zbatimin e kontratës. Dokumente të tillë duhet ti kthehen Autoritetit Kontraktues në fund të periudhës së zbatimit të detyrave.

12.2 Autoriteti Kontraktues do të bashkëpunojë sa më shumë të jetë e mundur me ofruesin e shërbimit pér të siguruar informacion që ky i fundit mund të kërkojë në mënyrë të arsyeshme pér të kryer kontratën.

12.3 Autoriteti Kontraktues do të caktoj “*Menaxherin e Projektit*”, i cekur në KVK, i cili do të jetë përgjegjës pér mbikëqyrjen e kryerjes së shërbimeve gjatë gjithë kohës dhe pér raportimin e çdo hollësie Autoritetit Kontraktues.

#### Neni 13      Dëmet e Likuiduara

13.1 Nëse Ofruesi i sherbimeve me përgjegjësinë e tij nuk arrin t'i realizoje ndonjë ose të gjitha sherbimet brenda limiteve kohore të specifikuara në kontratë, Autoriteti kontraktues, pa njoftim zyrtar dhe pa paragjykim ndaj kompensimeve tjera të tij sipas kontratës, do të ketë të drejtë, pér secilën ditë që kalon ndërmjet skadimit të periudhës së kontratës dhe datës aktuale të përfundimit, t'i marrë dëmet e likuiduara të barabarta me 0,25% në ditë të vlerës së sherbimeve të pa kryera deri në një maksimum prej 10 % të vlerës totale të porosise. Autoriteti Kontraktues mund të zgresë dëmet e likuiduara nga pagesat te cilat duhet ti behen Ofruesit te Sherbimeve. Pagesat e dëmet e likuiduara nuk do të prekin detyrimet e Ofruesit te Sherbimeve.

13.2 Nëse mos-ekzekutimi i ndonjërit sherbime parandalon përdorimin e zakonshëm të sherbimeve në tërësi, dëmet e likuiduara të parapara në paragrafin 13.1 do të llogariten në bazë të vlerës totale të porosise.

13.3 Nëse Autoriteti kontraktues ka fituar të drejtën të kërkojë së paku 10 % të vlerës së porosise ai mundet, pasi ta njoftojë me shkrim Ofruesin e Sherbimeve të:

a. *Ne rast se Autoriteti Kontraktues ka prokuruar vetem ne emer te vete Autoritetit, me një operatore ekonomik:*

- konfiskojë garancinë e performancës;
- te ndërpresë kontratën, dhe në këtë rast Ofruesi i Sherbimeve nuk do të ketë të drejtë pér kompensim; dhe
- të hyjë në një kontratë me një palë të tretë pér dhëni e pjesës së mbetur të sherbimeve. Ofruesi i sherbimeve nuk do të paguhet pér këtë pjesë të kontratës. Ofruesi i Sherbimeve gjithashtu do të jetë i detyruar të paguajë koston plotësuese dhe dëmet e shkaktuara nga kjo pamundësi e tij.

b. *Ne rast se Autoriteti Kontraktues ka prokuruar vetem ne emer te vete Autoritetit, me disa operatore ekonomik:*

- te konfiskojë garancinë e realizimit;
- te ndërpresë porosine, dhe në këtë rast Ofruesi i Sherbimeve nuk do të ketë të drejtë pér kompensim. Ofruesi i Sherbimeve gjithashtu do të jetë i detyruar të paguajë koston plotësuese dhe dëmet e shkaktuara nga kjo pamundësi e tij.

tij; dhe

- te ri-hap konkurrencën me pjesën e mbetur të Operatorëve Ekonomik të kontratës publike kornizë.

c. *Ne rast se Autoriteti Kontraktues ka prokuruar ne emer te disa Autoriteteve tjera Kontraktuese, me nje operatore ekonomik:*

- Autoriteti Kontraktues i cili ka bere porosine anulon porosine dhe ritenderon, dhe në këtë rast Ofriuesi i Shërbimeve nuk do të ketë të drejtë për kompensim. Ofriuesi i Shërbimeve gjithashtu do të jetë i detyruar të paguajë koston plotësuese dhe dëmet e shkaktuara nga kjo pamundësi e tij; dhe

- te njoftoj Autoritetin Kontraktues i cili ka udhëhequr prokurimin për sjellje të keqe të Operatorit Ekonomik dhe kërkon nga Autoriteti Kontraktues i përmendur qe të konfiskoj një pjesë proporcionale, ekuivalente me 10% te porosise se leshuar, të garancisë së performancës dhe dërgon shumën tek Autoriteti Kontraktues.

a. *Ne rast se Autoriteti Kontraktues ka prokuruar ne emer te disa Autoriteteve tjera Kontraktuese, me disa operatore ekonomik:*

- te njoftoj Autoritetin Kontraktues i cili ka udhëhequr prokurimin për sjellje të keqe të Operatorit Ekonomik dhe kërkon nga nga Autoriteti Kontraktues i përmendur qe të konfiskoj një pjesë proporcionale, ekuivalente me 10% te porosise se leshuar, të garancisë së performancës dhe dërgon shumën tek Autoriteti Kontraktues;

- te ndërpresë porosine, dhe në këtë rast Ofriuesi i shërbimeve nuk do të ketë të drejtë për kompensim. Ofriuesi i Shërbimeve gjithashtu do të jetë i detyruar të paguajë koston plotësuese dhe dëmet e shkaktuara nga kjo pamundësi e tij; dhe

- te ri-hap konkurrencën me pjesën e mbetur të Operatorëve Ekonomik të kontratës publike kornizë.

**Neni 14      Siguria e Ekzekutimit**

14.1 Ofriuesi i shërbimeve do të, jo më vonë se dita e nënshkrimit të kontratës, furnizoj Autoritetin Kontraktues me siguri për ekzekutim të plotë dhe të mire të kontratës. Shuma e sigurisë do të saktësohet në KVK. Siguria e ekzekutimit do të ndalet nga pagesa e Autoritetit kontraktues për çfarëdo humbjeje që është pasojë e mosekzekutimit të plotë dhe të duhur të obligimeve kontraktore nga ana e Ofriuesit të Shërbimeve.

14.2 Garancioni do të vazhdojë të mbetet i vlefshëm 30 ditë pas lëshimit të Çertifikatës së Përfundimit.

14.3 Garanconi i ekzekutimit të kontratës do të jetë në formatin e dhënë në Pjesën IV të kësaj kontrate.

**Neni 15                Sigurimi që do të merret nga Ofriuesi i Shërbimit**

15.1 Ofriuesi i Shërbimeve do të marr dhe do të ruaj, dhe do të shkaktoj Nënkontraktorët të marrin dhe ruajnë, me shpenzimet e tyre, por në bazë të kushteve të miratuara nga Autoriteti Kontraktues, sigurimin nga rreziqet, dhe për mbulim, siç do të specifikohet në KVK.

15.2 Ofriuesi i Shërbimeve, me kërkesë të Autoritetit Kontraktues, do të ofroj dëshmi për Autoritetin Kontraktues që sigurimi i tillë është marrë dhe ruajtur dhe se primet e tanishme janë paguar.

**Neni 16                Parimet të përgjithshme të pagesave**

16.1 Pagesat do të bëhen në Euro. Pagesat qe duhet te bëhen sipas faturës se leshuar nga Ofriuesi i Shërbimeve do të bëhen në llogarinë bankare të dhënë në Pjesën V, Identifikimi Financiar, i kësaj kontrate që e plotëson Ofriuesi i Shërbimeve. I njëjtë formular, që i bashkëngjitet kërkesës për pagesë, duhet të përdoret për t'i raportuar ndryshimet në llogarinë bankare.

16.2 Shumat duhet të paguhen brenda jo më shumë se 30 ditësh kalendarike nga data në të cilën kërkesa e pranueshme për pagesë është regjistruar nga departamenti përkatës. Data e pagesës do të jetë data në të cilën debitohet llogaria e institucionit. Kërkesa për pagesë nuk do të jetë e pranueshme nëse nuk plotësohen një ose më shumë nga kërkesat thelbësore.

16.3 Periudha prej 30-ditësh mund të pezullohet duke e lajmëruar ofruesin e Shërbimeve që kërkesa për pagesë nuk mund të plotësohet sepse shuma nuk do të paguhet për shkak se nuk janë dorëzuar dokumentet e duhura përbajtjesore ose sepse ka dëshmi që shpenzimi mund të mos jetë legitim. Në rastin e fundit mund të bëhet një inspektim i menjëherëshëm për qëllim të kontrollimeve tjera. Ofruesi i Shërbimeve do të japë sqarime, modifikime apo informata të tjera brenda 15 ditësh pas kërkesës. Periudha e pagesës do të llogaritet nga data në të cilën është regjistruar kërkesa për pagesë e përgatitur në mënyrën e duhur.

16.4 Pasi që të ketë kaluar afati i fundit i dhënë në Nenin 16.2, Ofruesi i Shërbimeve mundet që, brenda dy muajsh pas pagesës së vonuar, të kërkojë interesin për pagesë të vonuar me normë të re-zbritje që zbatohet nga Banka Qendrore e Kosovës në ditën e parë të muajit në të cilin ka skaduar afati i fundit, plus shtatë pikë të përqindjes. Interesi për pagesë të vonuar do të zbatohet për kohën që kalon ndërmjet datës së afatit të fundit të pagesës (nuk përfshihet) dhe datës në të cilën debitohet llogaria e Autoritetit kontraktues (përfshihet).

16.5 Të gjitha mos pagesat pas 90 ditësh nga skadimi i periudhës së dhënë në Nenin 16.2 do t'i jasin të drejtë Ofruesit të Shërbimeve që, ose të mos e realizojë kontratën, ose ta ndërpresë atë, me paralajmërim prej 30 ditësh për Autoritetin kontraktues.

16.6 Në rast se Autoriteti kontraktues kryen blerje në emër të autoriteteve të tjera kontraktuese, dhe një autoriteti kontraktues nuk i përbush detyrimet e tij sipas kësaj kontrate, veçanërisht obligimet e Nenit 16.2 ofruesi i shërbimeve mund të informojë AQP-ne për shkelje të tilla. AQP-ja mund të ndalojë autoritetin kontraktues nga përdorimi i çdo dhe të gjitha kontratat qendrore publike kornizë të nxjerra nga AQP.

#### Neni 17                    Kualiteti i Kontrollit

17.1 Parimi dhe modalitetet e Inspektimit të Shërbimeve nga Autoriteti kontraktues do të jenë si në KVK. Autoriteti kontraktues do të kontrollojë punën e ofruesit të shërbimeve dhe të njoftojë atë për çdo defekt që është gjetur. Kontrolli i tillë nuk do të ndikojë në përgjegjësitë e ofruesit të shërbimeve. Autoriteti Kontraktues mund të udhëzojë ofruesit e shërbimeve të kërkojnë një defekt dhe të zbulojnë dhe provojnë çdo shërbim që Autoriteti Kontraktues konsideron se mund të ketë një defekt. Periudha garantuese e defekteve është siç eshte definuar në KVK.

#### Neni 18                    Përmirësimi i Defekteve

18.1 Autoriteti kontraktues do të njoftojë ofruesit e shërbimeve për çdo Defekt para përfundimit të kontratës. Periudha garantuese e defekteve do të zgjatet për aq kohë sa Defektit të korrigohen.

18.2 Sa herë njoftimi për një defekt është dhënë, ofruesi i shërbimeve duhet të përmirësoj defektin e njoftuar brenda kohës së specifikuar në njoftimin e Autoritetit Kontraktues

18.3 Nëse ofruesi i shërbimeve nuk e ka korriguar defektin brenda kohës së specifikuar në njoftimin e Autoritetit Kontraktues, Autoriteti Kontraktues do të vlerësoj koston e korrigimit të defektit, ofruesi i shërbimeve do të paguaj këtë shumë, dhe do pasoj një dënim për mungesë Ekzekutimi që llogaritet siç përshkruhet në nenin 13.1.

#### Neni 19                    Konsekuençat e Shkeljes se kontratës

19.1 Pala ka shkelë kontratën nëse nuk arrin të shlyejë ndonjë nga obligimet e veta me kontratë siç është cekur ne Nenin 9 dhe 10.

19.2 Në rastet kur ndodh një shkelje e kontratës, pala e dëmtuar do të ketë të drejtë për këto kompensime:

- a) dëmet; dhe/apo
- b) ndërprerje të kontratës.

19.3 Përveç masave të sipërpërmendura, mund të jepen dëmshpërbime. Ato mund të janë:

- a) dëme të përgjithshme; ose
- b) dëme të likuidueshme.

19.4 Mbulimi i dëmeve, pagesat apo shpenzimet që rezultojnë nga zbatimi i masave të parapara në këtë nen do të zbatohen duke u zbritur nga shumat që duhet t'i paguhen Ofruesit të Shërbimeve, nga depozita, ose me pagesë nga siguria.

#### Neni 20 Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve

20.1 Palët duhet t'i bëjnë të gjitha përpjekje për të zgjidhur në mënyrë miqësore të gjitha mosmarrëveshjet që mund të ndodhin ndërmjet tyre. Sapo të shfaqet ndonjë mosmarrëveshje, palët do ta lajmërojnë njëra tjetrën me shkrim për qëndrimet e tyre në mosmarrëveshje dhe për ndonjë zgjidhje që ata konsiderojnë se është e mundshme. Nëse cilado palë e sheh të dobishme, palët do të takohen dhe të mundohen ta zgjidhin mosmarrëveshjen. Pala do të i përgjigjet kërkesës për zgjidhje miqësore brenda 15 ditësh pas kërkesës. Periudha maksimale që jepet për arritjen e kësaj zgjidhjeje do të jetë 30 ditë nga fillimi i procedurës. Nëse përpjekja për të arritur zgjidhje miqësore dështon ose nëse pala dështon të përgjigjet me kohë ndaj kërkesave për zgjidhje, të dyja palët do të janë të lira të vazhdojnë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes duke e lajmëruar tjetrën.

20.2 Nëse procedura e zgjidhjes miqësore të mosmarrëveshjes dështon, palët mund të merren vesh të përpilen të pajtohen përmes institucionit të specifikuar në KVK. Nëse nuk mund të arrihet zgjidhja brenda 30 ditësh pas fillimit të procedurës së pajtimit, secila palë do të ketë të drejtë të vazhdojë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes.

#### Neni 21 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

21.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë:

- a) vendim nga gjyqi; ose
- b) kurdo qe palët pajtohen, vendim arbitrimi në pajtim me KVK.

21.2 Para nënshkrimit te kontratës palët duhet te vendosin për mënyrën e zgjidhjes se mosmarrëveshjes, gjykata apo arbitrimi.

#### Neni 22 Dëmshpërbllimi

22.1 Ofruesi i shërbimeve do te mbroje dhe do te dëmshpërbuje Autoritetin Kontraktues, zyrtaret e tij dhe ish zyrtaret, drejtoret, punonjësit dhe agjentet e tij dhe do te jete përgjegjës për te gjitha shpenzimet, humbjet, demet, dhe pagesat e shkakuara nga Autoriteti Kontraktues, duke përfshire por jo kufizuar shpenzimet e tarifës se avokateve dhe shpenzimet ne lidhje me: neglizhencën ose keqpërdorimet e qëllimshme nga ana e ofruesit të shërbimeve, shkeljet apo shkeljet e pretenduar nga prezantimet e Ofruesit te Shërbimeve, pretendimet nga një palë e tretë se sigurimi i atyre shërbimeve nga ofruesi i shërbimit apo shfrytëzimi i tyre nga apo në emër të Autoritetit Kontraktues apo përdorimi ose sigurimi i ndonjë aseti te siguruar nga ofruesi i shërbimeve në lidhje me kryerjen e shërbimeve shkel të drejtat e pronësisë intelektuale të asaj pale të tretë

### PJESA III E KONTRATËS kushtet e vecanta

KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.

*[Udhezimet për plotësimin e KVK janë dhëne, sipas nevojes, në shenimet kurse të përmendura për nenet përkatese të KPK. Fshini ato jo relevante]*


Kushtet e Përgjithshme të Kontratës	Nr. Nenit	Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK
Përshkrimi i nenit		
Ligi i zbatueshëm dhe gjuha	2.1	Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen përfundimisht që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksi i KPK do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.
	2.2	Gjuha e përdorur do të jetë SHQIPE
Obligimet e Autoritetit Kontraktues	12.3	Menaxheri i Projektit është
Siguria e ekzekutimit	14.1	Shuma e Sigurisë së ekzekutimit është 12,000.00€.
Sigurimi që do të merret nga ofruesi i shërbimit	15.1	Rreziqet dhe mbulesat nga sigurimi do të janë: a) Mjetet motorike të Palës së Tretë <b>[sheno shumen]</b> b) Përgjegjësia e pales së tretë <b>[sheno shumen]</b> c) Përgjegjësia e punëdhënësit dhe kompensimi i punonjësve <b>[sheno shumen]</b> d) Përgjegjësia profesionale <b>[sheno shumen]</b> e) Humbje ose dëmtim të pronës dhe pajisjeve <b>[sheno shumen]</b>
Kualiteti i Kontrollit	17.1	Parimi dhe modalitetet e inspektimit të shërbimeve nga Autoriteti Kontraktues janë si më poshtë: <i>Pranimi i shërbimeve behet nga komisioni i pranimit.</i> Periudha e përgjegjësise së Defekteve është 10 ditë.
Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjes	20.2	<i>Bazuar në ligjet ne fuqi.</i>
Zgjidhja e mosmarrëveshjes me procedure gjyqësore	21.1	a) Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet <b>Gjykata koopetente</b> ose b) kurdo që palët pajtohen, çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në arbitrazh të <b>[specifiko organin për zgjedhjen e mosmarrëveshjes]</b> në pajtim me <b>[specifiko rregullat e arbitrazhit (irregular e Dhomas Nderkombetare të Tregtisë, Komisioni i Kombeve të Bashkuara mbi Ligjin e Tregtisë Nderkombetare, apo procedura të tjera të arbitrazhit të njohura ndërkombëtarisht)].</b>

**PARAMASA**

**Hartimi i projekteve për nevojat e Komunës të Kaçanikut(24 muaj)**

<b>A</b>	<b>Hartimi i projekteve Ideore dhe kryesore-Ndërtimi i lartë</b>	<b>Njësi</b>	<b>Sasi</b>	<b>Çmimi</b>	<b>Çmimi total</b>
1	<i>Hartimi i projektit-arkitektura, organizimi dhe funksionaliteti i objektit sipas standardeve dhe ligjeve të ndërtimit në fuqi.</i>	$m^2$	1	0.02 €	0.02 €
2	<i>Hartimi i projektit të enterierit-Arkitektura.</i>	$m^2$	1	0.02 €	0.02 €
3	<i>Hartimi i projektit-statika. Projektli duhet të punohet sipas standardeve dhe ligjeve të ndërtimit në fuqi.</i>	$m^2$	1	0.02 €	0.02 €
4	<i>Hartimi i projektit-ujësjellësi dhe kanalizimi. Projektli duhet të punohet sipas standardeve dhe ligjeve të ndërtimit në fuqi.</i>	$m^2$	1	0.02 €	0.02 €
5	<i>Hartimi i projektit-Elektrika, rrymat e dobëta dhe video monitorim, instalimet kabllore Lan, It, TV dhe rrufembarojtësi. Projektli duhet të punohet sipas standardeve dhe ligjeve të ndërtimit në fuqi.</i>	$m^2$	1	0.02 €	0.02 €
6	<i>Hartimi i projektit-Makineria, ngrojha qëndrora dhe ventilimi-klimatizimi. Projektli duhet të punohet sipas standardeve dhe ligjeve të ndërtimit në fuqi.</i>	$m^2$	1	0.02 €	0.02 €
7	<i>Shpimat gjemekonike dhe punimi i elaboratit gjemekonik sipas standardeve teknike. Shpini i llogaritetit m' duke përfshirë të gjitha fazat.</i>	$m'$	1	0.02 €	0.02 €
<b>Gjilhsej:</b>					<b>0.14 €</b>

<b>B</b>	<b>Hartimi i projekteve Ideore dhe kryesore për renovimin e objekteve-Ndërtim i lartë</b>	<b>Njësi</b>	<b>Sasi</b>	<b>Çmimi</b>	<b>Çmimi total</b>
1	<i>Hartimi i projektit renovues-Arkitektura. Në projekt duhet të futen bazat e objektit ekzistues, bazat e reja për renovim, paramasa dhe paralogaria si dhe të gjitha detalet e nevojshme.</i>	$m^2$	1	0.02 €	0.02 €
2	<i>Hartimi i projektit renovues-Statika. Në projekt duhet të futen bazat e objektit ekzistues, bazat e reja për renovim, paramasa dhe paralogaria si dhe të gjitha detalet e nevojshme.</i>	$m^2$	1	0.02 €	0.02 €
3	<i>Hartimi i projektit renovues-Elektrika. Në projekt duhet të futen bazat e objektit ekzistues, bazat e reja për renovim, paramasa dhe paralogaria si dhe të gjitha detalet e nevojshme.</i>	$m^2$	1	0.02 €	0.02 €
4	<i>Hartimi i projektit renovues-Ujësjellësi dhe kanalizimi. Në projekt duhet të futen bazat e objektit ekzistues, bazat e reja për renovim, paramasa dhe paralogaria si dhe të gjitha detalet e nevojshme.</i>	$m^2$	1	0.02 €	0.02 €
5	<i>Hartimi i projektit renovues-Makineria (ngrojha qëndrora, ventilimi dhe klimatizimi). Në projekt duhet të futen bazat e objektit ekzistues, bazat e reja për renovim, paramasa dhe paralogaria si dhe të gjitha detalet e nevojshme.</i>	$m^2$	1	0.02 €	0.02 €
<b>Gjilhsej:</b>					<b>0.10 €</b>



C	Hartimi i projektit të tereneve sportive, parqeve dhe oborreve sipas standardeve teknike duke përfshirë edhe matjet gjëodezike.	Njësia	Sasi	Çmimil	Çmimi total
1	Hartimi i projektit të rrugëve me më shumë se dy korësi sipas standardeve teknike për këtë kategoritë rrugës duke përfshirë edhe matjet gjëodezike.	m <sup>2</sup>	1	1.48 €	1.48 €
2	Hartimi i projektit të rrugëve me më shumë se dy korësi sipas standardeve teknike për këtë kategoritë rrugës duke përfshirë edhe matjet gjëodezike.	m <sup>2</sup>	1	0.02 €	0.02 €
3	Hartimi i projektit të rrugëve lokale dhe me dy korësi sipas standardeve teknike për këtë kategoritë rrugës duke përfshirë edhe matjet gjëodezike.	m <sup>2</sup>	1	0.02 €	0.02 €
4	Hartimi i projektit të rrugëve me kubëza duke përfshirë edhe matjet gjëodezike.	m <sup>2</sup>	1	0.02 €	0.02 €
5	Hartimi i projektit të trohuave duke përfshirë edhe matjet gjëodezike.	m <sup>2</sup>	1	0.02 €	0.02 €
6	Hartimi i projekteve të urave me hapësirë drile deri 10 m <sup>2</sup> me të gjitha fazat sipas standardeve teknike duke përfshirë edhe matjet gjëodezike.	m <sup>2</sup>	1	0.02 €	0.02 €
7	Hartimi i projekteve të urave me hapësirë drile mbi 10 m <sup>2</sup> me të gjitha fazat sipas standardeve teknike duke përfshirë edhe matjet gjëodezike.	m <sup>2</sup>	1	0.02 €	0.02 €
8	Hartimi i projekteve të mureve mbrojtëse sipas standardeve teknike duke përfshirë edhe matjet gjëodezike.	m <sup>2</sup>	1	0.02 €	0.02 €
9	Hartimi i projekteve të sinjalizimit të rrugëve.	m <sup>2</sup>	1	0.02 €	0.02 €
10	Hartimi i projektit për rregullimin e nyjeve të komunikacionit (udhëkryqova dhe rrethkërrötullimeve).	copë	1	0.02 €	0.02 €
11	Hartimi i projektit të nënkalimeve me të gjitha fazat e nevojshme sipas standardeve teknike duke përfshirë edhe matjet gjëodezike.	copë	1	0.02 €	0.02 €
12	Hartimi i projektit të mbikalimeve me të gjitha fazat e nevojshme sipas standardeve teknike duke përfshirë edhe matjet gjëodezike.	copë	1	0.02 €	0.02 €
13	Hartimi i projektit të parkingjeve sipas standardeve teknike duke përfshirë edhe matjet gjëodezike.	m <sup>2</sup>	1	0.02 €	0.02 €
14	Hartimi i projekteve të shpronësimit (elaboratë e shpronësimit).	m <sup>2</sup>	1	0.02 €	0.02 €
15	Hartimi i projekteve per ndryshimet e kufinjave kadastrale per gjate rrugëve	m <sup>2</sup>	1	0.02 €	0.02 €
16	Shpimet gjemekanike dhe punimi i elaboratit gjemekanik sipas standardeve teknike. Shpinë të llogaritet m <sup>2</sup> duke përfshirë të gjitha fazat.	m <sup>2</sup>	1	0.02 €	0.02 €
17	Hartimi i projektit të rrjetit elektrikë dhe ndriçimit publik.	m <sup>2</sup>	1	0.02 €	0.02 €
18	Hartimi i projektit të lëshesave pllakore sipas standardeve duke përfshirë edhe matjet gjëodezike.	m <sup>2</sup>	1	0.02 €	0.02 €
Gjillore:				1.82 €	




<b>D</b>	<b>Hartimi i projekteve ideore dhe kryesore-Objektit hidroteknicë</b>	<b>Njësi</b>	<b>Sasia</b>	<b>Çmimi</b>	<b>Çmimi total</b>
1	<i>Hartimi i projektit të kanalizimit fekal më të gjitha fazat sipas standardeve teknike.</i>	<i>m'</i>	<i>1</i>	<i>0.02 €</i>	<i>0.02 €</i>
2	<i>Hartimi i projektit të kanalizimit atmosferik më të gjitha fazat sipas standardeve teknike.</i>	<i>m'</i>	<i>1</i>	<i>0.02 €</i>	<i>0.02 €</i>
3	<i>Hartimi i projektit të ujësjellësit më të gjitha fazat sipas standardeve teknike.</i>	<i>m'</i>	<i>1</i>	<i>0.02 €</i>	<i>0.02 €</i>
4	<i>Hartimi i projektit për shtratin e lumenjëve dhe përroskave me të gjitha fazat sipas standardeve teknike.</i>	<i>m'</i>	<i>1</i>	<i>0.02 €</i>	<i>0.02 €</i>
5	<i>Hartimi i projektit për kanale të ujijes me të gjitha fazat sipas standardeve teknike.</i>	<i>m'</i>	<i>1</i>	<i>0.02 €</i>	<i>0.02 €</i>
5	<i>Hartimi i projektit për rezervoar të ujij me të gjitha fazat sipas standardeve teknike.</i>	<i>m³</i>	<i>1</i>	<i>0.02 €</i>	<i>0.02 €</i>
6	<i>Hartimi i projektit për gropat septike me të gjitha fazat sipas standardeve teknike.</i>	<i>m³</i>	<i>1</i>	<i>0.02 €</i>	<i>0.02 €</i>
7	<i>Mafjet gjeodezike.</i>	<i>m'</i>	<i>1</i>	<i>0.04 €</i>	<i>0.04 €</i>
				<b>Gjithsej:</b>	<b>0.18 €</b>

<b>E</b>	<b>Hartimi i projekteve per mbrojje nga zjarri, per objektet e kategorise II, sipas standardeve teknike. Projektit punohen prej personave te licencuar nga autoritelet perkatese</b>	<b>Njësi</b>	<b>Sasia</b>	<b>Çmimi</b>	<b>Çmimi total</b>
1	<i>Hartimi i projekteve per mbrojje nga zjarri, per objektet e kategorise II, sipas standardeve teknike. Projektit punohen prej personave te licencuar nga autoritelet perkatese</i>	<i>çope</i>	<i>1</i>	<i>0.02 €</i>	<i>0.02 €</i>
				<b>Gjithsej:</b>	<b>0.02 €</b>

Kategorizimi i objekteve eshte i shenuar ne Shtojcat e Udhezimit Administrativ 04/2017.

<b>F</b>	<b>Hartimi i raporteve pwr. Vlerësimin e Ndikimit ne Mjedis</b>	<b>Njësi</b>	<b>Sasia</b>	<b>Çmimi</b>	<b>Çmimi total</b>
1	<i>Hartimi i Raporteve per Vlerësimin e Ndikimit ne Mjedis. Raportet punohen per objektet te cilat duhet te pajisen me Leje Mjedisorre Komunale (LMK). Raportet duhet te punohen prej personave te licencuar nga autoritelet perkatese.</i>	<i>çope</i>	<i>1</i>	<i>0.02 €</i>	<i>0.02 €</i>
				<b>Gjithsej:</b>	<b>0.02 €</b>

Objektet te cilat duhet te pajisen me LMK janë te shenuara ne Shtojcen 1 te Udhezimit Administrativ 01/2017



**Vërtetje**

**Të gjitha çmimet e pozicioneve janë të logaritura me TVSH.**

**Të gjitha projektet duhet të shlyen në 3 kopje me ngjyra si dhe të dorozohet një kopje elektronike në CD. Në CD pjesa grafike duhet të jetë në PDF dhe DWG.**

**Të gjitha projektet duhet të punohen sipas datyrës projektuase të dhënë nga menaxheri i projektit.**

**Për të gjitha projektet duhet të punohen detajet e nevojshme për ekzekutim. Me kërkimin e menaxherit të projektit duhet të punohen edhe detalo shlejtë.**

**REKAPITULIM**

<b>A</b>	<b>Harilmi i projekteve ideore dhe kryesore-Ndërtimi i lartë</b>	<b>0,14 €</b>
<b>B</b>	<b>Harilmi i projekteve ideore dhe kryesore për renovimin e objekteve-Ndërtimi i lartë</b>	<b>0,10 €</b>
<b>C</b>	<b>Projektimi i Infrastrukturës rrugore-Ideore dhe kryesore</b>	<b>1,82 €</b>
<b>D</b>	<b>Harilmi i projekteve ideore dhe kryesore-Objektet hidroteknike</b>	<b>0,18 €</b>
<b>E</b>	<b>Harilmi i projekteve per mbrojtje nga zjarri, per objektet e kategorisë II</b>	<b>0,02 €</b>
<b>F</b>	<b>Harilmi i Raportit per Vlerësimin e Ndikimit ne Mjedis</b>	<b>0,02 €</b>
<b>Gjilësej:</b>		<b>2,28 €</b>

Kriteri i dhenjes se Kontratës çmimi me i lirë me poentim:

<b>A</b>	<b>Harilmi i projekteve ideore dhe kryetore-Ndërtimi i lartë</b>	<b>17.5 pikë</b>
<b>B</b>	<b>Harilmi i projekteve ideore dhe kryesore për renovimin e objekteve-Ndërtimi i lartë</b>	<b>12.5 pikë</b>
<b>C</b>	<b>Projektimi i Infrastrukturës rrugore-Ideore dhe kryesore</b>	<b>35 pikë</b>
<b>D</b>	<b>Harilmi i projekteve ideore dhe kryesore-Objektet hidroteknike</b>	<b>20 pikë</b>
<b>E</b>	<b>Harilmi i projekteve per mbrojtje nga zjarri, per objektet e kategorisë II</b>	<b>7.5 pikë</b>
<b>F</b>	<b>Harilmi Raportit per Vlerësimin e Ndikimit ne Mjedis</b>	<b>7.5 pikë</b>
<b>Totali:</b>		<b>100 pikë</b>

